

OSHEE GROUP sh.a njofton mbi hapjen e vendit vakant **Specialist** pranë OSHEE GROUP sh.a / Departamenti i Shërbimeve Mbështetëse / Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme / Sektori Arkivë.

SPECIALIST Arkive

Specialisti i Arkivës është përgjegjës për menaxhimin korrekt të dokumentacionit hyrës dhe dalës të institucionit, sipas rregulloreve të brendshme dhe procedurave të protokollit. Ai siguron qarkullimin efikas të shkresave zyrtare dhe ruajtjen e integritetit të të dhënave në librin e protokollit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Menaxhimi dhe organizimi i dokumentacionit fizik dhe elektronik të institucionit.
- Klasifikimi, sistemimi dhe arkivimi i dosjeve sipas rregullave dhe procedurave të arkivës.
- Regjistrimi dhe inventarizimi i dokumenteve hyrëse dhe dalëse.
- Ruajtja, mbrojtja dhe administrimi i dokumenteve zyrtare me kujdes për konfidencialitetin.
- Përgatitja e dokumenteve për dorëzim në arkivin qendror sipas afateve ligjore të ruajtjes.
- Kërkimi dhe gjetja e dokumentacionit të kërkuar nga strukturat e tjera të kompanisë.
- Digjitalizimi i dokumenteve dhe hedhja e të dhënave në sistemet elektronike.
- Kontrolli i plotësisë së dosjeve dhe verifikimi i dokumenteve sipas kërkesave.
- Bashkëpunimi me sektorët administrativë, teknikë dhe juridikë për menaxhimin e informacionit.
- Zbatimi i procedurave të brendshme të OSHEE Group dhe legjislacionit për arkivat.
- Përgatitja e raporteve periodike mbi gjendjen dhe administrimin e arkivës.
- Mirëmbajtja e rregullit në ambientet e arkivit dhe sigurimi i kushteve të përshtatshme për ruajtjen e dokumenteve.

Kualifikimet dhe kërkesat:

- Të ketë përfunduar Arsimin i Mesëm/i Lartë.
- Të ketë eksperiencë pune mbi 1 vit.
- Të ketë njohuri për programet bazë të kompjuterit.
- Aftësi shumë të mira komunikuese edhe punës në grup.
- Preferohet të ketë eksperiencë të ngjashme pune.

Të gjithë kandidatët e interesuar janë të lutur të bëjnë aplikimin në websiten e OSHEE group, në portalin e punësimit.

Ju njoftojmë se vetëm kandidatët e përzgjedhur do të ftohen për intervistë.